



BASHKIA MIRDITË

Nr. _____ Prot.

Rrëshen ____ . ____ .2021

**MIRATOHET
KRYETAR
Ndrec DEDAJ**

**PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR I SEKTORIT TË AUDITIMIT TË
BRENDSHËM NË BASHKINË MIRDITË PËR PERIUdhËN 2022 – 2024.**

Sektori i auditimit të brendshëm në Bashkinë Mirditë (NJAB) është ngritur në zbatim të ligjit për auditimin e Brendshëm në sektorin publik 114/2015 dhe të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “ Për Miratimin e Kritereve të krijimit të Njësive të auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, në mesin e vitit 2017 dhe vazhdon konsolidimin e saj në harmoni me Drejtoritë dhe sektorët e tjerë të aparatit të bashkisë në varësi direkte të Kryetarit të Bashkisë. Në zbatim të standarteve të auditimit stafi i kësaj njësie po punon për ngritjen e nivelit profesional të strukturës. Aktualisht sot NJ.A.B. Mirditë funksionon në nivel Sektorit.

Në hartimin e planit strategjik dhe vjetorë 2022-2024 jemi fokusuar në planifikimin me bazë risku, jemi përpjekur të identifikojmë risqet për çdo fushë në përputhje me standartet ndërkombëtare të auditimit, legjislacionin dhe Kartën e Auditimit të pranuar dhe shpallura nga Ministri i Financave.

Zhvillimi aktual i veprimtarisë audituese

Referuar planifikimit të auditimeve për vitin 2021 Ju informojmë mbi realizimin e angazhimit të auditimeve deri në periudhën aktuale të raportimit

Subjekte të planifikuara për auditim për vitin 2021(gjithsej 10 subjekte).

Nga këto:

- Ka përfunduar procesi i auditimit në pesë subjekte.
- Janë në proces auditimi një subjekt.
- Ska filluar procesi në katër subjekte.

Plani Strategjik dhe Vjetor 2022-2024

Ju bëjmë më dije se ndikim në realizimin e planit të auditimit për vitin 2021 ka patur dhe ka aktualisht pandemia Covid-19. Covid-19 ka prekur edhe personelin e NJAB. Gjatë këtij viti në strukturën e NJAB ka patur ndryshime, ku aktualisht nuk ka përgjegjës sektori, dhe NJAB funksionon me 2(dy) specialist.

Prioritetet për tri vitet e ardhshme

- Përmirësimi i frekuencës së auditimeve duke mbuluar me auditim të gjithë strukturën organizative dhe institucionet vartëse të bashkisë Mirditë.
- Përmirësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e gjetjeve dhe rekomandimeve për rregullimet përkatëse administrative dhe ligjore.

- Rritja e kompetencës së stafit me programe të diferencuara trajnimi në lidhje me metodat dhe praktikatat e reja të auditimit të brendshëm në sektorin publik.
- Ndjekja e realizimit të rekomandimeve.

Objektivat e NJAB

Hartimi i Planit Strategjik për auditimin e brendshëm për periudhën 2022 -2024, është mbështetur në objektivat e NJAB së Auditimit të Brendshëm, të cilat janë:

1. Dhënia e një sigurie objektive të arsyeshme për Titullarin mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës të përgatitura nga menaxhimi.
2. Shqyrtimi, vlerësimi dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe transaksionet lidhur me :
 - Risqet e brendshme të kontrollit të drejtimit.
 - Përdorimin me kursim, dobi dhe frytshmëri të burimeve financiare dhe njerëzore, të identifikojë fusha ku performanca e veprimeve mund të përmirësohet dhe të rekomandojë zgjidhje për dobësitë e sistemit të kontrollit.
 - Shkallën në të cilën rezultatet e programeve të subjektit të audituar plotësojnë objektivat e tij.
 - Pajtueshmërinë e veprimtarisë së subjektit të audituar me legjislacionin në fuqi.
 - Të shqyrtojë rregullat e ruajtjes së aseteve dhe sipas rastit të verifikojë ekzistencën e tyre, në zbatim të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, etj.

Për arritjen e këtyre objektivave për çdo vit hartohen dhe realizohen planet vjetore të punës së auditimit, të cilat mbështeten në vlerësimin e riskut, flukset e punës, ecurinë e objektivave, etj. Në përfundim të auditimeve të kryera, audituesit vlerësojnë nëse objektivat e mësipërme janë arritur ose e kundërta. Pra, i gjithë procesi i kryerjes së një auditimi, në përfundim finalizohet me përcaktimin e arritjes së objektivave të mësipërme.

Qëllimi i Planit Strategjik.

Qëllimi i hartimit të Planit Strategjik dhe planit vjetor të NJAB Bashkia Mirditë, është të përcaktojë prioritet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në përputhje me qëllimet e njësisë, për të siguruar se po e ushtron veprimtarinë në mënyrë efektive dhe në zbatim të planeve afat gjatë dhe afat mesëm të Bashkisë, si dhe me objektivat e përcaktuara.

Plani Strategjik dhe Vjetor 2022-2024

Plani strategjik rishikohet çdo vit me qëllim që të përditësojë nevojat për auditim në funksion të ndryshimeve të veprimtarisë, programeve dhe objektivave të subjekteve.

Për hartimin e tij jemi njohur me strukturat e njësisë të cilat do të auditohen, mjedisin ku operojnë si dhe risqet kryesore me të cilat përballet njësia.

Në hartimin e këtij plani janë mbajtur parasysh :

- Objektivat e NJAB
- Përparësitë në të cilat auditimi i brendshëm duhet të fokusohet.
- Frekuenca e auditimeve, parashikimi i zonave me risk më të lartë.
- Llogaritja e burimeve të kërkuara për auditimin e brendshëm.
- Plani i zhvillimit profesional për audituesit dhe trajnimet shpesh.
- Kufizimet e mundshme të qëllimit të auditimit.

Misioni i NJAB

Dhënia në mënyrë të pavarur e sistematike të një sigurie të arsyeshme për titullarin e Bashkisë Mirditë, për të përmirësuar veprimtarinë e subjektit publik dhe frytshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Roli i auditimit të brendshëm është t'i japë mbështetje titullarit të Bashkisë Mirditë në arritjen e objektivave të institucionit :

a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar si dhe ndryshimit të planit gjatë veprimtarisë vjetore audituese, nëse do këtë ndryshime.

b) duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:

i) identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;

ii) përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;

iii) ruajtjen e aseteve;

iv) besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;

v) kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;

vi) përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;

c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;

ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna

Kuadri Ligjor :

Funksionimi i auditimit të brendshëm në Bashkinë Mirditë, bazohet në Ligjin Nr.114/datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në akte të tjera ligjore e nën ligjore të cilat rregullojnë këtë veprimtari, Manuali i Auditimit të Brendshëm, trajnimet e vijueshëm profesional, praktikat profesionale ndërkombëtare që përmbajnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm .

Organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm :

Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mirditë, në zbatim të ligjit nr.114/2015, është një njësi që varet nga Kryetari i Bashkisë. Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashki është e përbërë nga 2 specialistë, ku të dy specialistët janë të çertifikuar dhe punësimi është bërë konform ligjit për Auditin e Brendshëm.

Identifikimi i subjekteve, fushave/sistemeve prioritare dhe vlerësimi i risqeve

Për periudhën 3-vjeçare (2022-2024), auditimi në Bashkinë Mirditë dhe njësitë vartëse, do të fokusohet në mbulimin me auditim të gjithë subjekteve të varësisë, gjë e cila do të realizohet në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016.

Për identifikimin e subjekteve që do të auditohen do të merren parasysh, objektivat e subjektit, fondet buxhetore që kanë në përdorim subjektet e audituara, fushat e veprimtarisë së këtyre subjekteve, riskun që mbulojnë këto subjekte, numrin e punonjësve të subjekteve, zbatimi i rekomandimeve të lëna, vlerësimin nga auditimi i mëparshëm, etj.

Në planin strategjik (2022 – 2024), janë planifikuar për tu audituar subjektet sipas viteve:

-**Viti 2022**, janë planifikuar për tu audituar 7 (Shtatë) subjekte, 5 (pesë) nga të cilët janë vlerësuar me risk të lartë dhe 2 (dy) subjekte me risk të mesëm.

-**Viti 2023**, janë planifikuar për tu audituar 12 (dymbëdhjetë) subjekte, nga të cilat 10 (dhjetë) subjekte me risk të mesëm dhe 2(dy) të vlerësuara me risk të ulët.

-**Viti 2024**, janë planifikuar për tu audituar 13 (trembëdhjetë) subjekte, nga të cilat 10 (dhjetë) janë vlerësuar me risk të mesëm dhe 3(tre) subjekte me risk të ulët.

Subjektet e planifikuara për çdo vit, janë të identifikuara në tabelën nr.2, bashkëlidhur këtij relacioni shpjegues.

Frekuenca e auditimit

Frekuenca e auditimit për subjektet e Bashkisë Mirditë, bazuar në këtë planifikim, nuk do të jetë më shumë se dy vite, me planifikimin e auditimit për detyrimet e prapambetura si dhe zbatimin e rekomandimeve, Realizimi i programit 3-vjeçar (2022-2024) dhe vjetor 2022, është i lidhur me disa faktorë të jashtëm dhe të brendshëm :

Faktorët e jashtëm :

1. Ndryshimet në legjislacion.
2. Struktura të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat ligjore.

Faktorët e brendshëm :

- Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditimit.
- Ndryshimi i numrit të subjekteve për auditim.
- Viti elektoral

Duke ju referuar këtyre faktorëve, plani i auditimit për 3 vitet e ardhshme është hartuar me qëllim mbulimin me auditim të të gjithë subjekteve të varësisë. Konkretisht janë planifikuar që për periudhën trevjeçare të mbulohen me auditim 100% e subjekteve të planifikuara për auditim.

Identifikimi i sistemeve dhe fushave të llogarisë

Një ndër hapat e parë gjatë hartimit të planit të auditimit të brendshëm është njohja me organizatën, mjedisin ku ajo vepron dhe risqet kryesore me qëllim që plani strategjik të fokusohet në sistemet/fushat që paraqesin risk më të lartë.

Fushat me risk më të lartë të identifikuar në Bashkinë Mirditë gjatë kryerjes së misionëve të auditimit janë:

- Sistemi i menaxhimit Financiar dhe kontrollit.
- Kundërvajtjeve administrative.
- Zbatimi i ligjshmërisë për fatkeqësitë natyrore.
- Detyrimet e prapambetura.

Risqet e identifikuar sipas sistemeve

Risqet e identifikuar sipas sistemeve janë vlerësuar si më poshtë:

- Cilësia e sistemeve të kontrollit të brendshëm
- Pajftueshmëria me bazën ligjore dhe rregullative
- Madhësia e subjektit të audituar
- Kompleksitetin e transaksioneve

Përparësitë ku fokusohet auditimi mbështeten në rezultatet e vlerësimit të riskut duke filluar nga risku më i lartë deri tek risku më i ulët. Mbi bazën e këtij vlerësimi të riskut përparësitë në auditim do të jenë :

1. Rregullshmëria e planifikimit dhe përdorimit të burimeve financiare.
2. Zbatimi i procedurave të prokurimeve dhe investimeve.
3. Mirë administrimi i vlerave materiale dhe respektimi i normave të përdorimit të tyre.
4. Përmirësimi i rregullave dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm me qëllim menaxhimit sa më të mirë të aseteve dhe burimeve për arritjen e objektivave nga subjekti i audituar.

Për të realizuar planifikimin strategjik konform standarteve është kryer identifikimi i risqeve sipas sistemeve të paraqitura në pasqyrën nr.1, bashkëlidhur këtij relacioni.

Kufizime të mundshme në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të auditimit

Qëllimi dhe objektivat e auditimit mund të mos arrihen si rezultat i ndikimit të disa faktorëve si :

1. Ndryshimet strukturore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm
2. Lëvizja e punonjësve të Auditimit të Brendshëm
3. Mbështetja materiale dhe motivimi në punë i punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
4. Mungesa e pavarësisë funksionale së audituesve.

► Planifikimi strategjik për vitet 2022- 2024 i veprimtarisë së NJ.A.B.

Sipas manualit të auditimit, në planin strategjik jemi përpjekur të përfshijmë të gjitha sistemet e identifikuar, fushat e veprimtarisë së vetqeverisjes vendore, në zbatim të reformës territoriale, ku qeverisja qendrore u ka transferuar të drejtat dhe detyrimet, për arsimin parashkollor dhe shërbimin sanitar në shkolla, agjensinë e pyjeve e kullotave , kullimit, zjarrëfikset etj. Për rrjedhojë pranë qeverisjes vendore janë krijuar drejtori e departamente të reja që janë mbajtur parasysh në hartimin e planit strategjik dhe vjetor të auditimit. Sektori i auditimit në Bashkinë Mirdite, në përllogaritjen e frekuencës së auditimit, i është referuar nevojave për auditim dhe mundësive për ta mbuluar me burimet që kemi në dispozicion.

Për sistemet dhe fushat që vlerësohen me nivel të lartë risku, është parashikuar të auditohen një here në dy vjet. Në hartimin e programeve të angazhimit të auditimit do të jepen drejtimit e auditimit dhe llogaritjet koha e nevojshme për të realizuar auditimin dhe kostot e çdo angazhimi. Faktorë të cilët i kemi pasur parasysh për këtë gjykim janë: rëndësia, materialiteti, ndryshimet e ndodhura apo që parashikohen për të ardhmen, vlerësimi i nivelit të riskut, opinionet e drejtuesve, shkalla e ndikimit të jashtëm, si dhe frekuenca e auditimit.

► Planifikimi vjetor 2022 i veprimtarisë së NJAB.

Planet e angazhimit për vitin 2022 janë të listuara sipas formularit nr.3, në kolonën nr.1 “subjekte për t’u audituar”, ku për sektorin tonë i kemi përcaktuar si subjekte të veçanta ato njësi të cilat konsiderohen njësi shpenzuese ku në rastin konkret kemi të bëjmë me

1. Bashkia Mirdite të listuara sipas tabelës.

Në total të planifikuara për auditim për vitin 2022 janë 7 (shtatë) subjekte.

Pasqyra 3

Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2022

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditim e Gjithsej (4.1+4.2+4.3+4.4+4.5+4.6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulencës	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
I	BASHKIA MIRDITE									
1	<i>Drejtoria e Financës & Buxhetit</i>	<i>Auditim në fushën e menaxhimit Financiar dhe kontrollit</i>	<i>1</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>1</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>2</i>
1.1	<i>Spektori i Menaxhimit Financiar</i>	<i>Auditim në fushën e menaxhimit Financiar dhe kontrollit Detyrimet e prapambetura</i>	<i>1</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>1</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>2</i>
2	<i>Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave.</i>	<i>Mënyra e funksionimit të Agjencisë në tërësi dhe sipas sektorëve.</i>	<i>1</i>	<i>1</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>2</i>
2.1	Inspektoriati i Ndërtimorë Urbanistik	Auditim mbi vendimet e marra nga IVMT për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi. Auditimi mbi vendosjen e gjobave, bashkëpunimi me drejtorinë e Financave	1	1	0	0	0	0	0	2
3	<i>Agjencia e</i>	<i>Funksionimi i</i>	<i>2</i>	<i>2</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>2</i>

Plani Strategjik dhe Vjetor 2022-2024

	<i>Shërbimeve Bujqësore-Veterinare dhe Pyjore</i>	<i>Agjencisë dhe bashkëpunimi me strukturat e tjera brenda bashkisë.</i>								
3.1	Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor	Auditimi dhe vlerësimi i sistemit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. Auditim mbi vlerësimin e dëmtimeve në pyje dhe kullota nga ndërhyrjet e paligjshme.	1	1	0	0	0	0	0	2
3.2	Sektori i Sh. Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	Monitorimi/hartimi i raporteve për situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë sipas territorit. Kontrole të ushtruara në mbrojtje të konsumatorit.	1	1	0	0	0	0	0	2
4	<i>NJESITË ADMINISTRATIVE</i>	<i>Organizimi dhe funksionimi i njësive Administrative.</i>	2	2	0	0	0	0	0	2
4.1	Njësia Administrative Rubik	Organizimi dhe funksionimi i njësisë.	1	1	0	0	0	0	0	2
4.2	Njësia Administrative Fan	Organizimi dhe funksionimi i njësisë.	1	1	0	0	0	0	0	2
5	<i>UJESJELLES KANALIZI MET Sh.a.</i>	<i>Auditim në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.</i>	1	0	0	1	0	0	0	2
	SHUMA	SHUM(1+2+3+4+5)	7	5	0	2	0	0	0	2

► **Planifikimi i kostos dhe burimeve të NJ.A.B.-ve.**

Një nga fazat e përgatitjes së planit vjetor është planifikimi i kostos dhe i burimeve sipas nevojave që paraqiten nga veprimtaria e njësisë së auditimit të brendshëm. Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar mbulimin me burime të përshtatshme të nevojave të auditimit në përgjithësi dhe sidomos të sistemeve me risk të lartë. Kjo për faktin se në një veprimtari auditimi, pjesa më e madhe e burimeve duhet të përqëndrohet në auditimin e sistemeve të vlerësuara me risk të lartë. Me konsolidimin e të dhënave, kosto për vitin 2022 rezulton afërsisht 1 678/ mijë lekë për Sektorin e auditimit, ndërsa kosto mesatare është 839/mijë lekësh për vetë faktin se Sektori i Auditimit përbehet nga 2/ auditues të brendshëm të punësuar në NJAB-në e Bashkisë Mirditë.

► **Planifikimi i nevojave për trajnim**

Një nga elementët që kemi mbajtur parasysh në planifikimin e nevojave për kualifikime është e percaktuar si kërkesë e ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” ku auditet në detyrë kanë të domosdoshme pjesëmarrjen në trajnimet përditësuese në nivelin e 40 orëve në vit. Kemi percaktuar sipas gjykimit tonë edhe disa nga drejtimet kryesore ku kemi nevojë të fokusohemi në keto trajnime, me qëllim përditësimin e njohurive dhe shkëmbimin e eksperiencës me kolegët e rretheve të tjera dhe me trajnerët.

Gjithashtu në përgatitjen e këtij plani duhet t’i referohemi edhe një fakti tjetër që është ndryshimi i mjedisit të kontrollit, si rezultat i implementimit të reformës territoriale, ku nga 7 njësi vendore që kishte rrethi i Mirditës kemi një Bashki, me 7/ njësi administrative. Struktura e auditimit të brendshëm përbëhet nga 2 specialist auditimi ku të 2 specialistët janë të certifikuar. Reformat e ndërmarra në fushën e menaxhimit të financave publike janë fokusuar në drejtim të rritjes së përgjegjësisë së menaxhimit për përdorimin me efektivitet, efizienz dhe ekonomi të fondeve publike dhe krijimin e përsosjen e një sistemi të qëndrueshëm dhe modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri. Ndryshimet në Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Ligjin për Inspektimin Financiar dhe Ligjin për Financat Vendore. Në zbatim të kuadrit ligjor në fushën e financave publike, synojmë një strukturim të sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Auditimit të brendshëm në përputhje të plotë me standartet ndërkombëtare të pranura

Si pjesë e rëndësishme e sistemit të KBFP është auditimi i brendshëm. Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm kryhet në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që të vlerësojë dhe përmirësojë strukturat e menaxhimit efektiv të riskut dhe të kontrollit të transaksioneve financiare dhe në këtë kuadër bëhet hartimi i një Plani 3-vjeçar dhe detajimi i Planit Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm.

Plani strategjik si dhe plani vjetor bazohen mbi një rishikim të përgjithshëm të sistemit të auditimit si dhe të sistemeve e proceseve që në kuadrin e reformës administrative-teritoriale janë ndërmarrë. Vlerësimi i nevojave të auditimit rishikohet çdo vit në kohën kur hartohet plani vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke u siguruar, që janë të përfshira në planin e konsoliduar të gjitha veprimtaritë e reja dhe/ose ndryshimet e tjera të programeve.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm me misionet e auditimit që kryen (subjektit të audituar) duhet të japë siguri titullarit se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efikasitet dhe sipas planit dhe qëllimit të miratuar me ligjin e buxhetit.

Sigurimi i Brendshëm i cilësisë

Rishikimi i punës audituese, ndikon drejtëpërsëdrejti në zbatimin e akteve ligjore, dhe nënligjore standardeve kombëtare e ndërkombëtare të auditimit lidhur me këtë veprimtari. Rishikimi i cilësisë i kërkon çdo anëtar të grupit të auditimit që të kuptojë plotësisht si përgjegjësitë e tij, ashtu edhe rolin e anëtarëve të tjerë të grupit të auditimit. Të gjithë anëtarët e Njësisë së Auditimit janë përgjegjës për paraqitjen e rezultateve të punës së tyre sipas Standardeve, me qëllim që ti mundësojnë një anëtar tjetër të hierarkisë së rishikimit që ta përfundojë punën e tij në mënyrë eficiente dhe të efektshme. Për këtë arsye rishikimi i punës audituese duhet të ushtrohet në të gjitha proceset dhe veprimtaritë që lidhen me shërbimin e auditimit.

Rishikimi i punës audituese është përgjegjësi e drejtuesit, dhe kryhet në varësi të niveleve të funksioneve organizative të strukturave të auditimit. Në kushtet konkrete të vendit tonë rishikimi i punës audituese duhet të realizohet nga: përgjegjësi i grupit të angazhimit, përgjegjësi i sektorit, çdo funksion tjetër i njësuar me këto pozicione dhe nga Drejtuesi i Njësisë së Auditimit.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë :

1. Vlerësimin e nivelit të risqeve për të gjithë subjektet që do të auditohen nga NjAB.
2. Planin strategjik të subjekteve të synuara për t'u audituar për vitet 2022-2024.
3. Planin e angazhimeve të NjAB për vitin 2022.
4. Planin e nevojave për trajnim të NjAB për vitin .
5. Planifikimin e buxhetit dhe shpërndarja e burimeve njerëzore të NjAB për vitin.